



REPUBLIKA E SHQIPERISE
MINISTRIA E EKONOMISE

Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme

URDHER

Nr. 157 Date 21.6.2004

PER

**TRANSFORMIMIN E NDERMARRJES SHTETERORE “UJESJELLES KANALIZIME”
LIBOHOVE, NE SHOQERI ANONIME “UJESJELLES KANALIZIME” SH.A LIBOHOVE**


Ne mbeshtetje te nenit 102, pika 4 te Kushtetutes se Republikes se Shqiperise, ne baze te nenit 1 te Ligjit nr. 8885, date 22.04.2002 “Per disa ndryshime ne ligjin nr. 7926, date 20.04.1995 “Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtare”, ndryshuar me Ligjin nr. 8067, date 15.02.1996, nr. 8099, date 28.03.1996, nr. 8158, date 07.11.1996, nr. 8482, date 10.05.1999; Dekretet nr. 1195, date 14.08.1995 dhe nr. 1615, date 20.09.1996, bazuar ne percaktimin nga eksperti kontabel i autorizuar i kapitalit themeltar te shoqerise qe do te krijohet nga transformimi i Ndermarrjes “Ujesjelles Kanalizime” Libohove, me qellim krijimin e akteve te themelimit te Shoqerise “Ujesjelles Kanalizime” Sh.a. Libohove, me cilesine e aksionerit te vetem te Shoqerise,

URDHEROJ :

1. Transformimin e Ndermarrjes “Ujesjelles Kanalizime” Libohove, ne Shoqeri te formes anonime “Ujesjelles Kanalizime” Sh.a. Libohove
2. Anetare te keshillit te pare mbikqyres emerohen:

Z. Ridvan Baxha
Znj. Luiza Mandi
Znj. Etleva Kondi
3. Ngarkohet Drejtoria e Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te ndjeke zbatimin e ketij urdheri.

Ky urdher hyn ne fuqi menjehere.


ANASTAS ANGJELI
MINISTER